



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.10.2023.
2. Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
3. Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “TEKSOEN 1”.
4. Mbi shtyrjen e vendimarrjes së bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC GOJAN.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e asetëve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.